

RAPORT TEKNIK

Objekti : “Rruga Ura e Serbinit - Stushaj”

Bashkia Bulqize

**Autor i Projektit
“ERALD - G” shpk**



VITI - 2020

PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TE PERGJITHSHME

- 1.01 Hyrje**
- 1.02 Vend Ndodhja e objektit**
- 1.03 Gjendja Egzistuese**
- 1.04 Foto te gjendjes egzistuese**

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- 2.01 Projekti i Rruges**
- 2.02 Veprat e Artit**

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

- 3.01 Preventivi me Çmime, Viti 2015**
- 3.02 Preventivi pa Çmime**
- 3.03 Volumet**

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. TE PERGJITHSHME

1.01 Hyrje

Njesia Administrative Shupenzë është pjesë administrative e Qarkut Dibër dhe ndodhet zonen verilindore te vendit.

NJA Shupenzë ose **Shupenza** është në [Rrethin e Bulqizës](#), në [Shqipëri](#).

Historia

Shupenza është qendra e Komunës dhe përfshin fshatrat e Grykës së Vogël, e cila përmendet për herë të parë më 1272, pronë e fisnikut arbër sevast Pal Gropa.

Më 1467, fshatrat e Grykës së Vogël bënin pjesë në Vilajetin e Dibrës së Sipërme si Topojani (Topoliani) 19 hane, Okshatina (Ohshatina) 15, Homeshi (Homish) 14 hane, Kovashica (Kovaçica) 24, Boçeva (Boçiva) 6, Shupenza (Shipançi) 3, Stushaj (Sushani) 9 dhe Bllaca (Blaçe) 13) dhe disa të tjerë në vilajetin e Gollobordës Çerenec (Ciranci) 14 hane, Gjoricë (Koriça) 2, Viçisht (Viçishta) 4 dhe Golovisht (Kolovishta) me 5 hane. Numri i pakët i banorëve ishte rrjedhojë e luftrave që ky popull kishte zhvilluar për 25 vjetë kundër pushtuesve osmanë.

Gjatë shek. XVIII – XIX, Gryka e Vogël ruajti vetëqeverisjen e saj si një ndër Malet e Dibrës. Më 1872, forcat ushtarake osmane të drejtuara nga Demir pasha dhe Osman aga sulmuan Grykën e Vogël. Malësorët organizuan qëndresën në Zogje, në kullën e Lam Dacit. Në ndihmë të tij shkuan dhe malësorët e Luznisë. Më 1878, Gryka e Vogël kishte 4 429 banorë myslimanë.

Më 1903, Mali i Grykës së Vogël kishte 16 fshatra me 600 shtëpi. Po aq frymë shkonin në luftë.

Më 1916, gjatë pushtimit austro – hungarez, Katundet e Epra (Gjuras, Bllacë, Zogje, Kovashicë, Stushën, Mazhicë e Topojan) me qendër në Zogje kishin 1 686 banorë, kurse fshatrat e Fushës (Okshatinë, Boçevë, Vlashe, Shupenzë, Çerenec, Gjoricë, Viçisht dhe Golevisht) me qendër Homeshin kishin 2 773 banorë. Më 1927, Gryka e Vogël u përfshi në nënprefekturën e Peshkopisë me 17 fshatra, 1 035 shtëpi dhe 6 672 banorë, të gjithë myslimanë.

Toponimia


Mikrotoponimia është e gurrës shqipe: Livadhet, Shkalla e Keqe, Gjoc, Kroj i Vjetër, Qafa e Vorreve, Shkalla e Haxhi Sinanit, Qafa e Vorreve, etj.

Komuna Shupenzë
Administrimi
Shqipëria
Qarku i Dibrës
Rrethi i Bulqizës

Komuna Shupenzë përbëhet nga 12 fshatra:

- 1 - Shupenzë
- 2 - Vlashaj
- 3 - Boçevë
- 4 - Homesh
- 5 - Okshatinë
- 6 - Kovashicë
- 7 - Zogjaj
- 8 - Shtushaj
- 9 - Topojan
- 10 - Mazhicë
- 11 - Gjuras
- 12 - Bllacë

Rruga Ura e Serbinit – Stushaj, shtrihet në të djathtë të rruges nacionale Peshkopi – Tiranë, në drejtim të Zogjajve.



Në Shupenzë dominon një reliev kodrinor i rrethuar nga fusha të mëdha në Jug dhe në lindje.

1.02 Vend Ndodhja e Objektit

Objekti “Rruga Ura e Serbinit - Stushaj”, ndodhet ne nje segment qe lidh qendren e fshatit me rrugen nacionale Bulqize – Peshkopi, me gjatesi rreth 5 293 ml. Rruga shtrihet ne anen Veriore te ish-komunes Shupenze.

1.03 Gjendja Aktuale e Objektit

Objekti aktualisht paraqitet ne nje gjendje jo te mire, ku gjate periudhes qe bien shira dhe reshje bore veshtiresohet se tepermi, pasi rruga eshte vetem ne trasene egzistuese ku asnjehere nuk jane bere nderhyrje per rikonstrukcion te saj. Pra ne kete rruge mungojne plotesisht shtresat rrugore dhe elementet e infrastruktures rrugore.

Ne kete rruge , nuk eshte bere asnjehere nderhyrje per rikonstrukcion te saj.

Sistemi i KUSH : mungon plotesisht. Ujrat rrjedhin ne trup te rruges, ne forme siperfaqesore sipas pjerresive natyrale te vete rruges, pasi kanalet anesore dhe veprat e artit mungojne plotesisht.

1.04 Foto te Gjendjes Aktuale e Objektivit

















2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekti i Rrugeve

Rruga Ura e Serbinit - Stushaj, eshte projektuar ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga Bashkia Bulqize.

Ajo do te kete nje gjeresi te pergjithshme prej 5.00 m, dhe do te perbehet nga :

- trupi i rruges me gjeresi 5.00 m
- pjesa e asfaltuar me gjeresi 4.00 m
- dhe ne te dyja anet bankine me gjeresi 2x0.50 m

Ne pjesen ne germim gjate gjatesise se rruges do te kete kanal anesor, per ujrat e shirave.

Rruga e projektuar ruan pergjithesisht aksin e rruges egzistuese duke bere permiresimet e mundshme gjeometrike te rruges.

- Shtresat ne trup te rruges

Paketa e plote e shtresave rrugore e percaktuar nga studimi i kryer do te permbaje keto shtresa :

- | | |
|--------------------------------------|---------|
| - shtrese asfaltobetoni | t=4 cm |
| - shtrese binderi | t=6 cm |
| - shtrese stabilizanti | t=10 cm |
| - shtrese zhavorri/çakelli mbeturine | t=20cm |

Kjo pakete e shtresave rrugore do te ndertohet pasi te jene bere punimet e germim-mbushjeve te niveletes se rruges, dhe pasi trupi i rruges (bazamenti) te jete cilindruar.

Shtresa e pare do te sherbeje edhe si shtrese profiluese e rruges.

Thuajse ne te gjithë gjatesine eshte parashikuar te ndertohet bordure betoni e larte + kanal betoni ose kanal betoni, ose bordure + kunete betoni, pasi rruga ne pjesen me te madhe ka pjerresi mbi 7%, dhe kjo behet qe te mbrohet trupi i rruges nga gerryerjet e ujrave siperfaqesore.

Per te gjithë muret dhe bordurat e larta duhet patur kujdes per lenien e vrimave te kullimit, qe do te realizohen me tuba PVC dia = 100 mm, te vendosur ne forme shahu çdo 1 ml. Niveli i vendosjes se tyre do te jete i njejte me ate te terenit, ne menyre qe te sigurohet kullimi i ujrave.

Projekti i Kanalizimeve dhe i Ujrave te Shirave

Rrjeti i kullimit te ujrave te shiut do te perbehet nga kanalet anesore te rruges, ne pjesen ne germim, pusetat dhe portalet e tombinove si dhe tubacionet prej betoni dhe çeliku qe do te ndertohen ne trupin e rruges. Tubacionet do te plotesojne te gjitha standartet ne fuqi dhe ne projektin e zbatimit jepen te gjitha normat dhe specifikimet e nevojshme. Kjo vlen edhe per te gjitha materialet e tjera qe do te perdoren. Pusetat e tombinove do te kene dimensione te ndryshme, kjo ne varesi te terenit dhe te dimensionit te tubit te tombinos.

Projekti i Sinjalistikes Rrugore

Ne projektin e sinjalistikes rrugore eshte parashikuar Sinjalistika Horizontale dhe ajo Vertikale.

- **Sinjalistika Horizontale** perbehet nga :
 1. Vijeziomet
 - a) Vijeziomi do te behet ne te dy anet e pjeses se asfaltuar, me gjeresi 12 cm sejcila.
 - b) Ne zonat prane degezimeve dhe kryqezimeve rrugore, do te vijezohej me vije te nderprere.
- **Sinjalistika Vertikale** perbehet nga :
 1. Tabelat treguese
 2. Guardrail

Shenim : Projekti i Sinjalistikes, gjate zbatimit te objektit, mund te ndryshohet ne varesi te skemes se qarkullimit, qe do te jepet nga Komuna Shupenze.

**“ERALD – G” Sh.p.k.
ADMINISTRATOR**

Ing. Gezim ISLAMI